

Si mund të mbrohem nga “phishing”?

Banka ProCredit është e angazhuar për të ofruar sigurinë e nevojshme në kryerjen e transaksioneve bankare online si dhe mbrojtur të dhënat e llogarive tuaja. Për ta përmbushur këtë, ProCredit Bank përdor programin më të fundit të sigurisë si dhe janë implementuar procese të shumta sigurie. Pavarësisht kësaj, ju duhet të dini se Interneti dhe e-mail-et mund të përdoren si mjete për qëllime dhe aktivitete joligjore. Për këtë arsye në gjithmonë ju rekomandojmë të merrni disa masa të thjeshta në mënyrë që të jeni sa më të sigurtë gjatë kryerjes së transaksioneve të ndryshme bankare.

Këshilla për të evituar “phishing”

Çfarë është “phishing”?

Phishing është një përpjekje për të aksesuar informacion sensitiv dhe personal, nëpërmjet e-maileve, të cilat duket sikur vijnë nga një kompani e besueshme që operojnë në Internet, por në fakt është një website fals, i cili kontrollohet nga pesona jo të besueshëm.

Çfarë informacioni do të më kërkohet?

E-mailet “phishing” zakonisht kërkojnë të bëhet “përditësim” ose “të verifikohet” informacioni për llogarinë tuaj. Nëpërmjet këtij e-maili të detyrojnë të klikosh në linkun që ata kanë vendosur në e-mail për të bërë përditësimin sa më shpejt. Ky link të dërgon në faqen e tyre të web-it. Çdo informacion që ju shkruani ruhet nga këto persona në mënyrë që ta përdorin në momentin më të volitshëm me qëllime mashtrimi.

Si të evitohet që të jem viktimë e “phishing”?

Çelësi për të qenë i sigurtë është të jesh mosbesues ndaj çdo e-maili të papritur, ose të pakërkuar nga ju, që vjen në e-mailin tuaj, edhe pse mund të duket sikur vijnë nga një burim i besueshëm. Keto e-maile janë dërguar me qëllimin për të kapur një adresë e-maili aktive, e cila i përket një klienti që ka llogari në institucionin që po synojnë të dëmtojnë.

Çfarë duhet të bëj nëse marr një e-mail “phishing”?

Nëse merrni një e-mail që ju duket i dyshimtë, ju lutem informoni menjëherë ProCredit Bank duke vizituar dëgen ose agjencinë tonë më të afërt, ose duke kontaktuar keshilluesin tuaj. Ju gjithashtu mund të telefononi në Qendrën e Kontaktit të ProCredit Bank +355 4 2 389 389.

E-mailin që keni marrë mund ta dërgoni në adresën e-mailit kujdesindajklientit@procreditbank.com.al


Për më shumë informacion, ju mund t'i referoheni specialistëve të website si:
<http://www.staysafeonline.org/stay-safe-online/keep-a-clean-machine/spam-and-phishing>

Keshilla të tjera sigurie

Si të dalloj një e-mail “phishing”?

E-mailet phishing mund të duken sikur vijnë nga një adresë zyrtare e-maili e ProCredit Bank. Fatkeqesisht, është shumë e lehtë për personat që praktikojnë “phishing”, të krijojnë një adresë e-maili fallco, si dhe të fshehin destinacionin final të një adrese të dërguar me link në e-mail.

Shembull i një e-maili “phishing”



Edhe nëse ProCredit Bank ju kontakton me e-mail, ky e-mail asnjëherë nuk do të përmbajë një link që t'ju çojë në një website që kërkon të vendosni informacionin tuaj personal (password, kodin e gjeneruar nga token etj.).

Çdo lloj veprimi i cili nuk ngjan me veprimet që ju bëni zakonisht në e-banking, ju këshillojmë ta shikoni si të dyshimtë. Në momentin që keni dyshim, kontaktoni me ProCredit Bank, duke vizituar një nga degët apo agjencitë tona, ose kontaktoni keshilluesin tuaj. Ju gjithashtu mund të telefononi në Qendrën e Kontaktit të ProCredit Bank +355 4 2 389 389, e cila është në dispozicionin tuaj 24 orë në 7 ditë të javës.